- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI : ” PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUE ”
INVESTITOR : BASHKIA KRUE
VENDODHJA : QYTET FUSHE - KRUE

Të përgjithshme

Bashkia ka si qëllim ofrimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e saj me standarte dhe performancë sa më të larta, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

PAMJE NGA GOOGLE



- Kompania private e kontraktuar duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane të prodhuara në territorin e Nësisë Administrative Fushë Krujë në qytetin e Fushe-Krujes dhe fshatrat e të realizojë transportin , depozitimin e tyre në vendgrumbullimin e rehabilituar (investim i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) në Kameron (Koder Dollake) sipas vendimit nr 5 datë 18.11.2020 I KOMITETIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE me një afat përdorimi deri në përfundimin të qendrave të trajtimit final të ndara sipas planit sektorial të udhëzimit Nr.1 datë. 13.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit

A.1.1 PERKUFIZIME

- Rrugët e asfaltuara do të thotë rrugë ose rrjetë të rrugëve të shtrëna me shtresa asfaltike që kufizohet në dy anë nga kufiri apo bordura, pa përfshirë kufirin apo trotuarin .

- Zona e mbulimit perfshin te gjithë territorin bruto (perfshire siperfaqet qe pastrohen,siperfaqet qe nuk pastrohen, siperfaqet ndertimore,shtet a privat) e percaktuar nga autoriteti kontraktor per te mbuluar me sherbimin e pastrimit, popullsia e seciles meret si baze per perlllogaritjen e sasise se mbetjeve urbane.
- Zona e rruges se asfaltuar (per tu pastruar me autofshese) do te thote nje zone qe mbulon hapesiren midis kunetave apo borduarave anesore te rruges , pa perfshire brenda saj kuneten , borduren apo bankinen .
- Personi/at mbikeqyres eshte nje person / ose grup personash qe ne proceduren e ketij sherbime jane pjese e stafit te Bashkise Kruje , caktuar nga Autoriteti Kontraktor qe eshte i ngarkuar te manaxhoje te gjithë aktivitet sipas preventivave dhe grafikeve te sherbimit
- Nivelet e cilesise se sherbimit jane standarte te kerkuara punimesh te percaktuara tek specifikimet te cilat Kontraktuesi do i permbahet gjate zbatimit te Kontrates.
- Punimet emergjente eshte nje komplet aktivitetesh te nevojshme dhe mjaftueshme per te pastruar rruget, sheshet , kontenieret si rezultat i fenomeneve natyrore me pasoja te pa parashikueshme, si stuhi te fuqishme, permbytje, dhe termete.
- Pika stacioneree e depozitimit mbetjeve urbane quhet vendi i caktuar nga Bashkia per depozitim e perkohshem te mbetjeve urbane, miratuar me pare nga strukturat perkatese shteterore , publike per kete qellim (procedure shpronesimi ne rastin kure prona eshte private) .
- Perjashtime quhen te gjitha rastet e mosperfshtirjes se sherbimit te pastrimit, depozitimit te mbetjeve urbane apo te mbetjeve te ngurta e te rrezikshme, larjes se rrugeve e shesheve, shkarkimit te mbetjeve urbane apo te ngurta ne gropen e depozitimit te mbetjeve , te cilat nuk lejohen qe te ushtrohet ky aktivitet nga qytetare, subjekte fizike apo juridike.

A.1.2 VECANTI E KESAJ KONTRATE

- Sherbimi i pastrimit te rrugeve e shesheve perfshin detyra te perhershme dhe te vecanta.
- Pastrimi i perditshem, perfshin sherbimin e perditshem te percaktuar dhe ne preventivat bashkelidhur,te vleresuar e percaktuar me pare ne preventiv.
- Pastrimi i vecante, perfshin pastrimet ne raste te paparashikueshme si raste stuhish,termetesh apo permbytjesh,volumet e te cilave dhe vlere e shpenzimeve percaktohen me preventiv te vecante.

A.2.1 PAGESAT NE ÇMIME NJESI

- Pagesat ne cmime njesi jane pagesat per punime e sherbime te rregullueshme bazuar ne sasite aktuale te kryera.
- Rregullat ne vijim per matjet dhe shperblimet do perdoren per punimet e rregullueshme nese nuk bihet dakord ndryshe:

- Mbikqyresi ruan te drejten te beje rivendosje midis zerave te ndryshem te pageses .
- Kontraktori do sipërmarre te kryeje punime qe korrespondojne zerave te pageses te specifikuar ne Preventiv .
- Pagesa do te paguhet ne perputhje me cmimin njesi te specifikuar ne preventiv per njesine qe eshte specifikuar, dhe sipas sasise aktuale , nese nuk eshte shenuar ndryshe per zerin e pagese ne specifikimet.
- Çmimet ne preventiv do mbulojne te gjitha kostot per funksionet e specifikuara plotesisht te arritura ose punime te perfunduara
- Zeri i caktuar i pageses do perfshije te gjitha kostot per burimet dhe operacionet e kerkuara per masat e specifikuara me qellim mbajtjen e vetive funksionale .
- Verifikimi i cilesise dhe sasise te punimeve te kryera do kryhet menjehere me plotesimin e punimeve. Verifikimet do mbyllen ne aktin e konstatimit (procesverbalin mujor) ku perfshihen zerat e punes te kryer ne baze te procesvebaleve ditore te hartuar nga konstatimet e kryera nga grupi i mbikqyrjes) e do vijohet me likuidimin e fatures mujore.

A.3 INSPEKTIMET DHE PROVAT

- Kontraktori do kryeje inspektime te nivelit te sherbimit ne rrjetin e rrugeve qe perfshijne gjithe aspektet qe mund te vleresohen me metoda te thjeshta, si inspektimet pamore dhe matjet e thjeshta qe nuk kerkojne pajisje komplekse.
- Çdo inspektim do dokumentohet nga nje raport i shkurter qe perfshin informacionin e detajuar .. Inspektimet do perfshijne bashke, kontroll dhe raportim mbi kushtet rrugore qe lidhen me zerat e kontraktuar sipas nje pagese njesi mujore.
- Tabela A.3 tregon shpeshtesine e kerkuar te inspektimit te rrugeve, shesheve, trotuareve, kontenireve e landfillit per nivelin e arritur te sherbimit per rrjetin e rrugeve subjekt i kesaj Kontrate (Zerat e paguar me pagesa mujore).
- *Tabela A.3*

Kategorite e pastrimit fshirjes , larjes,transportit e shkarkimit te mbeturinave , inerteve	<i>Rruget/sheshet/trotuaret (te asfaltuara)</i>
Shpeshtesia e inspektimit te Rrugeve	1/Jave

- Mbikqyresi i zbatimit te kontrates detyrohet te kryeje inspektime formale te niveleve te cilesise se sherbimit dhe sasise . Ai do te kryeje inspektime formale te detyrueshme, ne cdo kohe dhe ne cfaredo ze sherbimi qe perfshihet ne Kontrate.
- Mbikqyresi i zbatimit te kontrates do perdore burimet e tij per ato inspektime. Nese ai dallon cfaredo seksioni ku nivelet e cilesise se sherbimit nuk jane arritur, ai eshte i detyruar te informoje Kontraktorin brenda 24 oreve me shkrim, me qellim qe ai te mund te marre veprime ndreqese se me shpejt.
- Rezultatet e inspektimeve formale do perdoren nga mbikqyresi i projektit per te korrigjuar Certifikatat Pagesore Mujore te Kontraktuesit ose per te aplikuar zbritje pagesash / gjoba demesh, me perjashtim te rasteve kur egzistojne shkaqe te arsyeshme per kryejten e zerave te sherbimit , kur nuk eshte plotesuar kriteri i Perdorueshmerise se Rruges/sheshit/trotuarit etj.

- Pavaresisht nga sa me siper njoftimi si i tille eshte formal dhe Kontraktori duhet ti permbahet kufijve kohore specifikuar me poshte ne kapitullin B 2.
- Ne rastet kur mbikqyresi eshte nje person i jashtem perzgjedhur me proceduren perkatese ligjore , Kontraktori do vendose, brenda struktures se tij organizative, nje Njesi Vete-Kontrolli te vacante te plotesuar me personel te kualifikuar, detyra e te cilit eshte te monitoroje dhe mbeshtese verifikimin e shkalles se perputhjes me Nivelet e Cilesise se Sherbimit. Njesi e Vete-Kontrollit gjithashtu do kryeje ose organizoje prova dhe matje; pergatise, paraqese dhe dorezoje tek Mbikqyresi i Rruges gjithe informacionin me qellim krijimin e dokumentacionit te percaktuar ne Specifikimet dhe manexhimin dhe mirembajtjen efektive te rrugeve. Njesia e vete-kontrollit do kryeje gjithashtu ose monitoroje, ne bashkepunim te ngushte me Mbikqyresin e Projektit, verifikimet mbi Nivelet e Cilesise se Sherbimit.

A.4 VERIFIKIMET

- Niveli i arritur i cilesise se sherbimit do verifikohet nepermjet inspektimit te perbashket nga mbikqyresi i projektit dhe Kontraktori. Inspektimi i Perbashket do kryhet disa here ne muaj .
- Inspektimet e Perbashketa do kryhen ne te gjitha rruget e sheshet e asfaltuara dhe te paasfaltuara ne administrim te Nj.Ad. Fushe – Kruje Bashkise Kruje. Cdo inspektim i Perbashket do dokumentohet nga nje Raport Mujor Verifikues i Perbashket.
- Gjate Inspektimeve te Perbashketa, Mbikqyresi i Projektit detyrimisht do fuse ne Raportin e Perbashket Mujor Verifikues: (i) rrethanat e pergjitheshme te vendit te vizites, duke perfshire daten, seksionet rrugore (apo sheshe etj) te vizituara, personat e pranishem, etj., (ii) cfaredo mospajtimi qe mund te jete dalluar, dhe (iii) kohen e lejuar per ndreqjen e difekteve te dalluara, nese kufijte kohore nuk jane specifikuar sipas zerit aktual te pageses.
- Mbi bazen e rezultateve te Inspektimit te Perbashket, Mbikqyresi i Projektit do te :
- Beje korrigjimet / zbritjet ne paqyren mujore te Kontraktuesit (bazuar ne numrin e pikeve te denimeve te dhena), nese verehet ndonje mos-pajtim, dhe ta vertetoje ate per pagese nga Punedhenesi,
- Te perfshije dhe nese eshte e nevojshme, korrigjoje Raportin e Perbashket Mujor Verifikuesen (per tu firmosur nga Kontraktori dhe Mbikqyresi i Projektit se bashku), dhe
- Te dorezoje nje kopje te Pageses Mujore tek Kontraktori.
- Inspektimet e Perbashketa do perfshijne gjithashtu edhe vizita kontrolli ne terren te seksioneve, per te cilat jane verifikuar defektet dhe brenda kufijve kohore te caktuara nga Mbikqyresi i Projektit dhe te specifikuara Raportin e Perbashket Mujor Verifikues.
- Qellimi i ketij inspektimi kontrolli eshte qe te kontrolloje nese Kontraktori i ka ndrequr shkaqet e mos-pajtimeve te meparshme, brenda afatit te percaktuar nga Menaxheri i Projektit. Per rrjedhoje keto inspektime kontrolli te perbashketa do te kryhen vecmas,

menjehere pas skadimit te kufijve kohore te vena. Nga ana formale keto inspektime te perbashketa mundet vetem te perdoren per kontrollin e shenimeve te meparshme.

- Inspektimet e perbashketa do kryhen nga Njesia e Vete-Kontrollit te Kontraktorit ne bashkeveprim me, dhe nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Projektit. Mjetet fizike qe nevojiten per inspektimin do sigurohen nga Kontraktori.

A.5. PASTRIMI , FSHIRJA ME AUTOFSHESE , FSHRJA ME FSHESE , PASTRIMI I SIPERFAQEVE URBANE , LARJA E RRUGEVE , TRANSPORTI I MBETJEVE URBANE DHE .

- Kriteri per zbatimin e pikeve te denimit dhe zhdemtimeve:
- Mos-pajtim me detyrimet e specifikuara kontraktuale per pastrimin, larjen, transportin e mbeturinave e shkarkimin e pleherave ne landfill qe jane:
- Nivel sherbimi aktual, nen nivelin minimal te specifikuar te sherbimit;
- Mos arritja e cilesise se specifikuar te punimeve te kryera;
- Numeri i pikeve te denimit per secilin ze ne Specifikimet (Prev Nr.2) do jete:

Zeri	Pike/Rruge; shesh, kontenjer, territor.
Pastrim me autofshese i rrugeve,shesheve e trotuareve	1
Pastrim me fshese i rrugeve,shesheve e trotuareve	1
Pastrim , transport mbetje urbane	1
Larje rruges, sheshesh e trotuaresh.	1
Pastrim territori urban.	1
Sistemim e ngarkim , transport mbetje inerte etj	1

- Mos-plotesim i kufijve te specifikuar kohore te aprovuar ne Grafiket Kohore te Kontraktuar ose kufijve kohore te vena nga Mbikqyresi i Projektit per te ndrequr demet

A.6 DETYRAT ADMINISTRATIVE TE KONTRAKTORIT

- .6.1 INSPEKTIMET E ZAKONSHME
- Kontraktori eshte i detyruar te kryje inspektime ditore, nga e hena ne te djele, duke perfshire dhe ditet e festave duke perfshire dite – pushimet perjashtoj ditet e diela , ne rruget,sheshet, kontenjeret e landfillin, brenda Kontrates.

- Pas inspektimit Kontraktori do pergatise nje raport mbi zonen e inspektuar dhe ky raport do informoje mbi cka vijon:
- Liste e informacionit paresor:
- Data e inspektimit te zakonshem,
- Emri dhe numri identifikues i zones(rruges,sheshit,kontenjerit,landfilli(gropa) etj),
- Kush po e realizon,
- Shenime mbi mangesite sipas seksionit dhe dhe zerit,
- Niveli i arritur i sherbimit (mbi/nen /nivel minimal),
- Vellimi i vleresuar.
- Ne te tilla raste Kontraktori do te sipermarre masat e nevojshme per te manexhuar

- trafikun dhe per te informuar Mbikqyresin e Projektit per ngjarjen, menjehere pas zbulimit apo njoftimit te ngjarjes.
- Per realizimin e ketij prokurimi Bashkia Kruje ka hartuar dokumentacionin teknik te nevojshem, ku perfshihen keto zera punimesh:

1.Pastrim me autofshese i rrugeve, shesheve e trotuareve

2.Pastrim me fshese i rrugeve, shesheve e trotuareve

3.Transport mbetje urbane

4.Larje rrugesh , sheshesh e trotuaresh

5.Pastrim territori urban.

6.Sistemim e ngarkim me eskavator, 0.25 m3 , transport

- Është parashikuar që në qytetin e Fushe-Krujes çdo ditë prodhohen afersisht 15.22 ton / ditë mbetje urbane për 364 dite sherbimi ne vit. ose 17.56 ton / ditë mbetje urbane për 312 dite sherbimi ne vit. .
- Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zëra të tjerë shërbimi të detajuara si më poshtë sipas dhe preventivit të shërbimit

1. Pastrim me autofshese i rrugeve, shesheve e trotuareve

Ne kete sherbim perfshihet :

Realizimi i sherbimit te pastrimit te rrugeve, shesheve e trotuareve brenda territorit te Nj.Ad. Fushe - Kruje, te cilat jane brenda zones urbane dhe suvurbane te qytetit Fushe Kruje, rruge, sheshe e trotuare te cilat aktualisht jane te asfaltuara dhe kane mundesi te pastrohen me auto fshese (kushtet dhe permasat e rrugeve, shesheve e trotuareve ja lejojne nje sherbim te tille duke mundesuar levizjen e autofsheses), sipas tabelës se rrugeve, shesheve e trotuareve bashkelidhur.


Per realizimin e ketij sherbimi eshte parashikuar qe te perdoret autofshese (mjet teknologjik) me kapacitet 3 - 4 m³, i cili ben te mundur fshirjen e rrugeve e shesheve, thithjen e pluhurave e mbeturinave, ngarkimin, perpunimin e shkarkimin e tyre. Per realizimin e ketij sherbimi jane parashikuar te perdoren fshesa tip “ flutur ” dhe fshese tip “ rrul ”, per te gjithë periudhen vjetore te sherbimit.

Ky mjet referuar dhe praktikave te ngjashme te ketij sherbimi si Bashkia Vlore mund te realizoje pastrimin e siperfaqes se parashikuar cdo dite sipas grafikut te sherbimit ditor mesatarisht 4.5 – 5 ore / dite , ku eshte llogaritur rruga vajtje – ardhje , ndalesa , etj.

Per te plotesuar kete sherbim, ne dispozicion te autofsheses do te jene dhe 1 (nje) punonjes pastrimi i cili do te bejne gerryerjen e materialeve te forta qe nuk i gerryen dot makineria, si dhe ngarkimin e mjeteve te ngurta qe demtojne makinerine dhe ne raste te vecanta me trafik, komandimin e makinerise.

Ky proces eshte parashikuar te jete pa nderprerje, per gjithe vitin (264 dite), 22 dite / muaj , nga ora 20.⁰⁰ - 24.⁰⁰ (orari mund te ndryshohet ne varesi te kushteve klimatike 5 ore/dite). Duke pasur ne konsiderate fluksin e mjeteve , vizitoreve kryesisht vendas qe qarkullojne vecanersiht ne segmentet pjese e rrugeve nacionale pjese e ketij zeri sherbimi eshte parashikuar qe ky proces te kryhet domosdoshmerisht ditën e shtune te çdo jave .

Lista e rrugeve dhe shesheve me pastrim ditor jepen ne tabelen bashkangjitur.





Per percaktimin e kostos dhe ofrimin e cmimit njesi te ketij zeri sherbimi, per te realizuar kete proces sherbimi ofertuesit duhet te japin keto oferta:

Oferten per cmimin njesi te pastrimit me autofshese (analiza e kostos per 1m2/muaj).

Oferten per cmimin njesi te pastrimit me autofshese (analiza e kostos per 1 m2/vit).

Preventivin oferte per pastrimin me autofshese e 27 500 m2 rruge e sheshe ne 1 muaj çdo dite .

Preventivin oferte per pastrimin me autofshese e 27 500 m2 rruge e sheshe ne 1 vit , çdo dite

Preventivin permbledhes per gjithë sherbimin e pastrimit mujor.

Preventivin permbledhes per gjithë sherbimin e pastrimit vjetor.

Grafiket e sherbimit ditor , mujor , vjetor .

Ne cmimin njesi do te perfshihen:

- Shpenzimet per pagen e manovratoreve e punetoreve si dhe shtesen mbi pagen , referuar akteve ligjore per nivelin e pagave minimale oreve per pastrim dhe numrit te diteve.
- Shpenzime per materialet materialet si rroba e vegla pune te punonjesve qe do te realizojne kete sherbim dhe karburante gazoil e lubrifikante , fshesa te mjetit.

- Shpenzime per makinerite si amortizimi i mjetit referuar normave ne fuqi,shpenzime per pjese kembimi mjetesh dhe dokumentacion mjeti (siguracion,taksa,leje qarkullimi etj).
- Shpenzime per transportin, perfshire vetem karburantin gazoil per hyrje – daljen e mjetit teknologjik ne kantier.
- Gjithashtu ne keto cmime do te perfshihen dhe shpenzimet plotesuese dhe fitimi i ligjshem, te cilat duhet te jene mbi shumen e shpenzimeve direkte .

Per realizimin e ketij procesi pune te kihen parasysh dhe rregulloret e pastrimit dhe vecanerisht masat e sigurimit teknik , te cilat ndikojne ne llogaritjen dhe percaktimin e cmimit njesi.

Ne oferten per cmimin njesi te zerit te pastrimit me autofshese te rrugeve, shesheve e trotuareve, operatoret ekonomik mund te shtojne ndonje shpenzim te padhene ne tabelen per analizen e cmimit njesi qe ata e gjykojne te domosdoshem dhe mund te heqin ndonje ze te dhene ne analizen e cmimit njesi te cilet ata e gjykojne si te tepert, por pa ndryshuar strukturen baze ligjore te analizes se cmimit njesi te dhene nepermjet udhezimeve ne fuqi dhe duke ruajtur normativat fikse ne fuqi dhe volumet e numrin e dhene, te cilat jane te detyrueshme.

2. Pastrim me fshese i rrugeve, shesheve e trotuareve

Ne kete sherbim perfshihet :

Realizimi i sherbimit te procesit te pastrimit me fshese i rrugeve, shesheve e trotuareve brenda territorit te zones urbane dhe suburbane te qytet Fushe - Kruje, te cilat jane brenda dhe perreth, rruge, sheshe e trotuare te cilat aktualisht jane te asfaltuara (shtresa asfaltike ose betoni) dhe nuk kane mundesi te pastrohen me autofshese (kushtet dhe permasat e rrugeve , shesheve e trotuareve nuk ja lejojne nje sherbim te tille, prandaj do te pastrohen me fshese). Eshte parashikuar te pastrohen me fshese dhe per faktin se ne teresine e tyre nuk jane shume te ndotura cka eliminon perdorimin e makinerise .

Per realizimin e ketij sherbimi eshte menduar qe keto rruge, sheshe e trotuare do te pastrohen me fshesa te zakonshme me punonjes pastrimi, materiali i grumbulluar do te ngarkohet, perpunohet e transportohet me karroce dore, per tu transportuar me vone nga automjetet ne dispozicion.

Ky proces eshte parashikuar te jete pa nderprerje, per gjithe vitin (264 dite / vit) 22 dite / muaj , nga ora 05.⁰⁰ - 12.⁰⁰ (orari mund te ndryshohet ne varesi te kushteve klimatike , 8 ore / dite). Referuar dhe praktikave te ngjashme te ketij sherbimi si subjekte te njejta , konkretisht Bashkia Vlore cdo punetor mund te realizoje pastrimin e siperfaqes se parashikuar 7000 m2 cdo dite sipas grafikut ditor per rreth 8 ore pune.

Lista e rrugeve dhe shesheve me pastrim ditor jepen ne tabelen bashkangjitur.

Per percaktimin e dhe ofrimin e çmimit njesi te ketij zeri sherbimi, per te realizuar kete procesherbimi ofertuesit duhet te japin keto oferta:

Oferten per cmimin njesi te pastrimit me fshese (analiza e kostos per 1m2/muaj).

Oferten per cmimin njesi te pastrimit me fshese (analiza e kostos per 1 m2/vit).

Preventivin oferte per pastrimin me fshese e 20 650 m2 rruge e sheshe ne muaj , çdo dite.

Preventivin oferte per pastrimin me fshese e 20 650 m2 rruge e sheshe ne 1 vit, çdo dite

Preventivin permbledhes per gjithe sherbimin e pastrimit mujor.

Preventivin permblledhes per gjithë sherbimin e pastrimit vjetor.

Grafiket e sherbimit ditor , mujor , vjetor.

Ne cmimin njesi do te perfshihen :

- Shpenzimet per pagen e punetoreve , si dhe shtesen mbi pagen , referuar akteve ligjore per nivelin e pagave minimale oreve per pastrim dhe numrit te diteve .
- Shpenzime per materialet si rroba e vegla pune te punonjesve qe do te realizojne kete sherbim.
- Gjithashtu ne keto cmime do te perfshihen fitimi i ligjshem, vlere qe do jete mbi shumen e shpenzimeve direkte.

Per realizimin e ketij procesi pune te kihen parasysh dhe rregulloret e pastrimit dhe masat e sigurimit teknik, te cilat ndikojne ne llogaritjen dhe percaktimin e cmimit njesi.

Ne oferten per cmimin njesi te zerit te pastrimit me fshese te rugeve, shesheve e trotuareve,operatoret ekonomik mund te shtojne ndonje shpenzim te padhene ne tabelen per analizen e cmimit njesi qe ata e gjykojne te domosdoshem dhe mund te heqin ndonje ze te dhene ne analizen e cmimit njesi te cilet ata e gjykojne si te tepert, por pa ndryshuar strukturen baze ligjore te analizes se cmimit njesi te dhene nepermjet udhezimeve ne fuqi dhe duke ruajtur normativat fikse ne fuqi dhe volumet e numrin e dhene, te cilat jane te detyrueshme.

3. Pastrim , transport mbetje urbane

Ne kete sherbim perfshihet :

Realizimi i sherbimit te mbledhjes, grumbullimit,ngarkimit, perpunimit e transportit te mbetjeve urbane per te gjithë territorin e zones urbane te qytetit dhe zones suburbane (nje zone qe i korespondon nje popullesi rreth 28 636 banore e ku ky sherbim do ofrohet per rreth 15 000 – 17 000 banore), qe perfshin Qytetin Fushe Kruje dhe zonen suburban te Nj.Ad. Fushe Kruje, te cilet i grumbullojne mbetjet urbane te tyre cdo dite ne 182 konteniere te vendosur ne PGM (sipas hartave bashkelidhur) .

Per realizimin e ketij sherbimi eshte menduar qe ky proces te realizohet kryesisht ne mesnate dhe ne agim , paraditje (shih grafikun), me 2 (dy) mjete teknologjike per ngarkimin , perpunimin e transportimin e ketyre mbetjeve, shoqeruar me 2 (dy) punetore secili mjet teknologjik per te ndihmuar ne kete proces sherbimi. Ky sherbim referuar praktikave te ngjashme te ketij sherbimi si Bashkia Vlore do te kryhet nga dy mjete teknologjike me kapacitet 6 - 8 m3 (qe mundeson pastrimin ne pika problematike sa i perket levizjes se mjetit) dhe 6 - 8 m3 ose 8 - 12 m3. Ky proces perlllogaritjet te kryhet 2 min per boshatisje kontenieri , 0.5 min per dizinfektim + fshirje dhe 2 – 2.5 min per levizjen nga nje pike ne tjetren. Perlllogariten 65 - 70 pika me 182 konteniere.

Nj.Ad. Fushe Kruje , Bashkia Kruje ve ne dispozicion te subjektit 182 konteniere te kapaciteteve 1100 dhe 660 litra. Pjesa tjeter prej 22 konteniere me kapacitet 1100 litra do te sigurohen nga subjekti. Pikat e grumbullimit te mbetjeve duhet te pastrohen e mirembahen ne nje siperfaqe prej 8 – 10 m2 per secilin kontenier.

Ato duhet te dezinfektohen periodikisht me gelqere pluhur dhe tretesire hipoklorit natriumi 10 – 14 % me pompe..

Ky proces do te realizohet gjate 312 diteve te vitit ose 364 dite / vit duke pergfshire dhe ditet e djela dhe numri i zbrazjeve mund te jete edhe 2 here/dite, ne rastet e grumbullimit te sasive me te medha te mbetjeve nga ato te parashikuara ne normat e krijimit te mbetjeve urbane, por duke respektuar vlere totale te fondit limit te percaktuar ne dokumentat e tenderit .

Per percaktimin e dhe ofrimin e cmimit njesi te ketij zeri sherbimi, per te realizuar kete proces sherbimi ofertuesit duhet te japin keto oferta :

Oferten per cmimin njesi te transportit te mbetjeve urbane (analiza e kosos per 1ton/dite).

Oferten per cmimin njesi te transportit te mbetjeve urbane (analiza e kosos per 1ton/muaj).

Oferten per cmimin njesi te transportit te mbetjeve urbane (analiza e kosos per 1 ton/vit).

Preventivin oferte per transportin e 17.56 ton mbetje urbane ne dite per 312 dite ose 15.22 ton mbetje urbane ne dite per 364 dite.

Preventivin oferte per transportin e 456.7 ton mbetje urbane ne muaj.

Preventivin oferte per transportin e 5480 ton mbetje urbane ne 1 vit.

Grafiket e sherbimit ditor , mujor , vjetor


Ne cmimin njesi do te perfshihen:

- Shpenzimet per pagen e shofereve e punetoreve si dhe shtesen mbi pagen , referuar akteve ligjore per nivelin e pagave minimale oreve per pastrim dhe numrit te diteve .
- Shpenzime per materialet materialet si rroba e vegla pune te punonjesve qe do te realizojne kete sherbim dhe karburante zazoil e lubrifikante per mjetet teknologjike .
- Shpenzime per automjetet si amortizimi i mjetit referuar normave ne fuqi, shpenzime per pjese kembimi mjetesh dhe dokumentacion mjeti (siguracion, taksa, leje qarkullimi etj).
- Shpenzime per transportin, perfshire vetem karburantin gazoil e lubrifikante per hyrje-daljen e mjetit teknologjik ne kantjer .
- Gjithashtu ne keto cmime do te perfshihen dhe shpenzimet plotesuese dhe fitimi i ligjshem, te cilat duhet te jene mbi shumen e shpenzimeve direkte.

Per realizimin e ketij procesi pune te kihen parasysh dhe rregulloret e pastrimit dhe masat e sigurimit teknik, te cilat ndikojne ne llogaritjen dhe percaktimin e cmimit njesi.

Ne oferten per cmimin njesi te zerit te transportit te mbetjeve urbane, operatoret ekonomik mund te shtojne ndonje shpenzim te padhene ne tabelen per analizen e cmimit njesi qe ata e gjykojne te domosdoshem dhe mund te heqin ndonje ze te dhene ne analizen e cmimit njesi te cilet ata e gjykojne si te tepert, por pa ndryshuar strukturen baze ligjore te analizes se cmimit njesi te dhene nepermjet udhezimeve ne fuqi dhe duke ruajtur normativat fikse ne fuqi dhe volumet e numrin e dhene, te cilat jane te detyrueshme.





4. Larje rrugesh , sheshesh e trotuaresh

Ne kete sherbim perfshihet :

Realizimi i sherbimit te larjes se rrugeve, shesheve e trotuareve do te realizohet per te gjithë pjesen asfaltike te rrugeve kryesore (shih tabelen bashkelidhur), sherbim i cili do te realizohet me mjet teknologjik te posaçem per realizimin e ketij sherbimi (autobot me pompe me presion per larje rrugesh), me qellim pastrimin e mbeturinave qe mbeten ne rruge pas kryerjes se procesit te pastrimit ditor, proces i cili nuk ben pastrimin e plote te rruges pasi ne rruge mund te kete mbetje te veçanta si vajra, mbetje te momentit etj, te cilat se bashku me pluhurat e rruges, krijojne ndotje te medha gjate oreve te dites e me trafik.

Realizimi i ketij sherbimi eshte menduar te realizohet ne dy inetrvale kohore (shih grafikun). Sasia e ujit prej 24 m3 uje ne dite do te sigurohet pa pagese ne shpime te zones .

Realizimi i shërbimit të larjes së rrugëve , shesheve , trotuareve do kryhet me mjet autobot me kapacitet 7500 – 8500 litra dhe një punëtor ndihmes . Ky proces do kryhet për 7 orë / çdo ditë , orar ky i llogaritur vetëm për procesin e larjes. Nuk përfshihet në këtë interval kohë koha e vajtja - ardhje e mjetit nga parkimi dhe kohezgjatja për mbushjen e autobotit.

Ky proces do të realizohet gjatë gjithë 7 muajve të vitit për 147 ditë / vit duke përjashtuar ditët me shi gjatë kësaj periudhe.

Për përcaktimin e dhe ofrimit të cmimit njësi të këtij zeri shërbimi, për të realizuar këtë proces shërbimi ofertuesit duhet të japin këtë ofertë :

Oferten për cmimin njësi të larjes së rrugëve, shesheve, trotuareve (analiza e koston për 1 m²/muaj).

Oferten për cmimin njësi të larjes së rrugëve, shesheve, trotuareve (analiza e koston për 1 m²/vit).

Preventivin oferte të larjes së rrugëve, shesheve, trotuareve për 45 000 m² / ditë .

Preventivin oferte të larjes së rrugëve, shesheve, trotuareve për 45 000 m² në 1 muaj , çdo ditë

Preventivin oferte të larjes së rrugëve, shesheve, trotuareve për 45 000 m² në 1 vit , çdo ditë

Preventivin përmbledhës për gjithë shërbimin larjes së rrugëve , shesheve dhe trotuareve mujor.

Preventivin përmbledhës për gjithë shërbimin larjes së rrugëve , shesheve dhe trotuareve vjetor.

Grafikët e shërbimit ditor , mujor , vjetor

Në cmimin njësi do të përfshihen :

- Shpenzimet për pagën e shofereve e punëtorëve si dhe shtesën mbi pagën , referuar akteve ligjore për nivelin e pagave minimale orë për pastrim dhe numrin e ditëve .
- Shpenzime për materialet si rroba e vegla pune të punonjësve që do të realizojnë këtë shërbim dhe karburante zazoil e lubrifikante për mjetet teknologjike .
- Shpenzime për automjetet si amortizimi i mjetit referuar normave në fuqi, shpenzime për pjesë këmbimi mjeteve dhe dokumentacion mjeti (siguracion, taksa, leje qarkullimi etj).
- Gjithashtu në këtë cmim do të përfshihen dhe shpenzimet plotëse dhe fitimi i ligjshëm, të cilat duhet të jenë mbi shumën e shpenzimeve direkte.

Për realizimin e këtij procesi pune të kihen parasysh dhe rregulloret e pastrimit dhe masat e sigurimit teknik të cilat ndikojnë në llogaritjen dhe përcaktimin e cmimit njësi.

Në oferten për cmimin njësi të zërit larjes së rrugëve , shesheve dhe trotuareve , operatorët ekonomik mund të shtojnë ndonjë shpenzim të padhënë në tabelën për analizën e cmimit njësi që ata e gjykojnë të domosdoshëm dhe mund të heqin ndonjë zë të dhënë në analizën e cmimit njësi të cilet ata e gjykojnë si të tepert, por pa ndryshuar strukturën bazë ligjore të analizës së cmimit njësi të dhënë nepermjet udhëzimeve në fuqi dhe duke ruajtur normativat fikse në fuqi dhe volumet e numrin e dhënë, të cilat janë të detyrueshme.

5. Pastrim territori urban

Ne kete sherbim perfshihet:

Realizimi i sherbimit te procesit te pastrimit te territorit urban , brenda territorit te qytetit Fushe Kruje, territor i cili eshte brenda dhe jashte zones urbane te qytetit Fushe Kruje, territor i cili

aktualisht eshte i pa asfaltuar dhe nuk ka mundesi te pastrohet me autofshese apo fshese (kushtet dhe permasat e rrugeve, shesheve e trotuareve nuk ja lejojne nje sherbim te tille, prandaj do te pastrohen vetem mbetjet e tilla si letra, qese etj. me punetore), kryesisht problematike e shfaqur ne blloqet e pallatave , skarpitet e perrenjve , siperfaqet e gjelberta (segmente rrugore , qender , hyrje e qytetit).

Per realizimin e ketij sherbimi eshte menduar qe keto terriore do te pastrohen me punonjes pastrimi, materiali i grumbulluar do te ngarkohet e transportohet me karroce dore, per tu transportuar nga mjetet ne dispozicion .

Ky proces eshte parashikuar te jete kryhet gjate vitit 264 dite , 8 ore / dite.

Referuar praktikave te ngjashme ky sherbim do te kryhet nga 2 (dy) punetore per siperfaqe prej 17 650 m² / cdo dite. Duke qene se siperfaqja per kete lloj sherbimi eshte me e madhe se parashikimi ditor do te alternohen zonat ku do te kryhet ky sherbim nga Bashkia Kruje.

Lista e ketyre zonave , siperfaqeve te gjelberta etj me pastrim ditor jepen ne tabelen bashkangjitur.

Per percaktimin dhe ofrimin e cmimit njesi te ketij zeri sherbimi, per te realizuar kete proces sherbimi ofertuesit duhet te japin keto oferta:

Oferten per cmimin njesi te pastrimit te territorit urban(analiza e kostos per 1m²/muaj).

Oferten per cmimin njesi te pastrimit te territorit urban(analiza e kostos per 1 m²/vit).

Preventivin oferte per pastrimin e territorit urban te 17 650 m² rruge e sheshe ne muaj , cdo dite.

Preventivin oferte per pastrimin e territorit urban te 17 650 m² rruge e sheshe ne 1 vit , cdo dite .

Preventivin permbledhes per gjithë sherbimin e pastrimit mujor.

Preventivin permbledhes per gjithë sherbimin e pastrimit vjetor.

Preventivin permbledhes per gjithë sherbimin e pastrimit ditor.

Grafiket e sherbimit ditor , mujor , vjetor

Ne cmimin njesi do te perfshihen:

- Shpenzimet per pagen e punetoreve , si dhe shtesen mbi pagen , referuar akteve ligjore per nivelin e pagave minimale oreve per pastrim dhe numrit te diteve .
- Shpenzime per materialet si rroba e vegla pune te punonjesve qe do te realizojne kete sherbim.
- Gjithashtu ne keto cmime do te perfshihen fitimi i ligjshem, vlere qe do jete mbi shumen e shpenzimeve direkte
- Per realizimin e ketij procesi pune te kihen parasysh dhe rregulloret e pastrimit dhe masat e sigurimit teknik, te cilat ndikojne ne llogaritjen dhe percaktimin e cmimit njesi.

Ne oferten per cmimin njesi te zerit te pastrimit te territorit urban, operatoret ekonomik mund te shtojne ndonje shpenzim te padhene ne tabelen per analizen e cmimit njesi qe ata e gjykojne te domosdoshem dhe mund te heqin ndonje ze te dhene ne analizen e cmimit njesi te cilet ata e gjykojne si te tepert, por pa ndryshuar strukturen baze ligjore te analizes se cmimit njesi te

dhene nepermjet udhezimeve ne fuqi dhe duke ruajtur normativat fikse ne fuqi dhe volumet e numrin e dhene, te cilat jane te detyrueshme.

6. Sistemim , ngarkim me eskavator ne mjet 0.25 m3 , transport me auto

Ky shëbim përfshin grumbullimin e ngarkimin me eskavator / fadome me goma , me kovë 0.25 m3 , ngarkim ne mjet e transport me auto. Kryesisht jane mbetje inerte qe krijohen si rezultat i

depozitimit neper rruge nga reshjet e shiut , mbetje inerte neper PGM , shkurre e barishte e mbeturina te tjera kryesisht pjese te mobilimit te familjeve qe nuk perbejne mbetje qe klasifikohen ne mbetje te kategorive te rrezikshme. Ky shëbim do kryhet 2 dite ne jave , 8 dite ne muaj 96 dite / vit me nje sasi te perlogaritur prej 1070 m3 / vit.

Per percaktimin edhe ofrimin e cmimit njesi te ketij zeri shërbimi, per te realizuar kete proces shërbimi ofertuesit duhet te japin keto oferta

Oferten per cmimin njesi (analiza e kostos per leke m3/muaj).

Oferten per cmimin njesi (analiza e kostos per leke m3/vit).

Preventivin oferte per 1070 m3 inerte etj gjate nje viti.

Preventivin oferte per 89.16 m3 inerte etj gjate nje muaji .

Preventivin permbledhes per gjithë shërbimin e pastrimit mujor.

Preventivin permbledhes per gjithë shërbimin e pastrimit vjetor.

Grafiket e shërbimit ditor , mujor , vjetor.

Llogaritja e cmimit njesi eshte bazuar ne v.k.m. nr 216 datev 13.04.2023 “ Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim dhe sasia e mesatarizuar e inerteve , zhavorrishteve etj per kete ze shërbimi.

Per kryerjen e shëbimeve te mesiperme nevojiten ;

Nr	Emërtimi i mjetit	Nr	Shofer	Manovrator	Punëtor
1.	.Autofshesë	1	1		1
2.					3 (fshirje me fshese)
3.	Mjet teknologjik	1	1		2
4.	Mjet teknologjik	1	1		2
5.	Autotobot uji	1	1		1
6.					2 (pastrim territori urban)
7.	Kamion vetëshkarkues	1			
8.	Eskavator / fadromë me goma	1		1	

Makineritë e nevojshme që duhen për kryerjen e shërbimit

Lloji i makinerisë & mjeteve (pajisjes)	Njesia	Sasia
Autofshesë me kapacitet 3 - 4 m 3 ,me fshesa rrul e flutur.	copë	1

Kamion vetëshkarkues me peshë mbajtëse 5 ton	copë	1
Fadrome me goma me kapacitet te koves 0.25- 1 m3	copë	1
Autobot uji për larje rrugësh.	copë	1
Kontenierë mbeturinash 1100 litra (1.1 m3)	copë	22
Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet 6 - 8 m3	copë	1
Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet 8 - 10 m3	copë	1

Lista e shërbimeve të përfshira në pastrim të Njesie Fushe – Krujë qytetit , fshatrat

Nr	Emërtimi i shërbimeve	Njësia	Sasia
1	Pastrim me autofshese të shesheve dhe trotuaresh	M2	27500
2	Pastrim me fshesë të rrugëve	M2	20650
3	Grumbullim , transport mbetje urbane	Ton	5480
4	Larje rrugësh sheshesh të trotuaresh	M2	45000
5	Pastrim territori urban	M2	17650
6	Grumbullim dhe ngarkim mbetjeve të inerte, barishte dhe materialeve të ngurta	M3	1070

1.1 Frekuencat e grumbullimit

a. Në qytetin e Fushe-Krujës shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet çdo ditë. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, nga ora 03.⁰⁰ deri në orën 10.⁰⁰ , kështu do të evitohen orët me trafik.

b. Mbetjet do të grumbullohen një ose dy herë në ditë në 100 % të të gjitha pikave të grumbullimit të mbetjeve për qytetin dhe fshatrat sipas grafikut të shërbimit ditë , muajt , vjetor . Normalisht aty ku ka aktivitet më të dendur të bizneseve.

Orët e operimit për frekuencën e dytë do të jenë ndërmjet orës 14⁰⁰..- 17⁰⁰.

1.2 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

a. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit .

b. Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të kontraktuesit ose nga Autoriteti Kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njërit palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit Kontraktor.

c. Autoritetit Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

1.3 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të pa transportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.

b. Kontraktuesi ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit

ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Kontraktuesi duhet të ketë krijojë kushtet për marrjen e ankesave për shërbimin që ofrohet. Kontraktuesi duhet të vendosë në automjetet e pastrimit numrin e telefonit si dhe

adresën e internetit për ankesa. Përfaqësues të kontraktuesit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t'u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara pas marrjes së njoftimit. Kontraktori duhet të krijojë një listë për ankesat me indikacionin për vendodhjen, tipin, përshkrimin dhe përcaktimin e masës së marrë. Kontraktori do të sigurojë një kopje javore të kësaj liste për Bashkinë.

d. Kontraktuesi detyrues duhet të ketë sipas grafikut të shërbimeve çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.


e. Kontraktuesi detyrues duhet të ketë sipas grafikut të shërbimeve çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

f. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

g. N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballtet me penaltetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

i. Përdorimi i uniformave dhe masave të sigurimit teknik për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

Mjetet e grumbullimit do të jenë të paisura me llampa përpara si dhe prapa kamionit, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e punonjësve. Këto llampa do të jenë gjithë kohës funksionale gjatë punës natën.

Lloji i mjetit	Mjet teknologjik grumbullues dhe transportues (kompaktor)
Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit)	6 – 8 ton 8 - 10 ton 
Raporti i kompaktimit	KokKoprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (përkatësisht 6 -8 dhe 8 - 10 ton / ngarkese)
Kapja dhe ngarkimi i mjetit në pjesën fundore	Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1100 litra (1.1m ³) 
Rrotat e mjetit	Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lirisht në territore malore dhe të mbuluara me borë

--	--

a. Makinë teknologjike grumbulluese dhe transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 6 - 8 ton dhe 8 - 10 ton, komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (10 ton max) ;

1.4 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt . Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjëndje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.

d. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mbliidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

1.5 Personeli

a. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon mbetjet. Personeli nuk lejohet të kryejë riciklim në përfitim të tij apo të kompanisë gjatë orëve të punës së grumbullimit të mbetjeve në mënyrë që të evitohet humbja e kohës dhe nxitet grumbullimi. Gjatë transportit në landfill, punëtorët nuk duhet të shoqërojnë mjetin por duhet të ofrojnë të tjera shërbime pastrimi për qytetin.

b. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi . Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik nëpunë.

1.6 Dezinfektimi i PGM

Volumet e punimeve

a.Duhet të bëhet dezinfektimi i zonës përrëth kontenierëve, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezinfektimit manuale, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

b.Frekuenca e dizinfektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhën Maj-Shtator (ditë mërkure dhe shtunë) , ndërsa periudhën tjetër të vitit, Tetor - Prill 2 (dy) herë në muaj.

1.7 Menaxhimi dhe mirembajtja e konteniereve

Pronësia e kontenierëve është e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për ruajtjen ,menaxhimin e tyre.

Menaxhimi i kontenierëve:

a.Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

b. Këto kontenierë janë pronë e Bashkisë Kruje.Kompania kontraktuese duhet te kete nje sasi prej 22 kontenieresh ne dispozicion per zevendesimin e konteniereve ekzistues kur keto te fundit i nen shtrohen riparimeve te mundeshme ose ndonje procesi tjetër trajtimi.Ne rastet e demtimeve me dashje ,djegjes, vjedhjes ose cdo rasti tjetër qe shkakton mos permbushjen e kapaciteteve fizike te kryerjes normale te funksionit te tyre ,kompania kontraktuese duhet te lajmeroje autoritetin kontraktor zyrtarisht brenda dites ne rastet e konstatuara per mbajtjen e process-verbaleve ne terren si dhe do te marri masa ne zevendesimin e tyre ku ne fund te perfundimit te kontrates keta konteniere jane perseri prone e kompanise kontraktuese

c.Autoriteti kontrktor ka planifikuar te investoje per vitin 2025 blerjen e rreth 30 – 35 konteniereve metalike 1100 litrash, me rrota, sipas normave EN DIN 840 . Furnizimi dhe me pas ndarja do behët sipas planit te shperndarjes te miratuar ne zonat ku eshte parashikuar i perfshire qyteti Fushe Kruje dhe rrethinat .

Mirëmbajtja e kontenierëve:

- a.** Kontenierët e dëmtuar sistematikisht duhet të zëvendësohen me një të riparuar, transportohen dhe rregullohen nga Autoriteti Kontraktor. Kontraktuesi ka për detyrë të monitorojnë.
- b.** rregullisht gjendjen fizike të kontenierëve, dhe të mbajnë një inventar për të gjithë kontenierët, të cilin duhet ta raportojë tek Autoriteti Kontraktues. Në këtë inventar kontraktuesi duhet të japin sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme
- c** Kontraktuesi duhet të mbajnë një rezervë prej 22 (njezet e dy) kontenierësh, të cilët do të përdoren për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim. Dëmtimet e mundshme, të cilat duhet te riparohen brenda 5- ditëve të evidentimit, janë:
 - rrotat
 - dorezat,
 - deformime të ndryshme të kontenierit.lyerja e kontenierëve,

d. Përsa kohë konteneirët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenerët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.

1.8 “ Edukimi Publik Mjedisor ”

a. Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i Kontraktori për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, grafikët, rrugetimet, praktikët e mira dhe te keqija të qytetareve dhe bizneseve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

b. Kontraktori duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së Kontraktorit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Kompania do të sigurojë gjithashtu një faqe interneti ku të gjitha informacionet do të paraqiten qytetareve (rrugetimet, pikat e grumbullimit, grafikët, praktikët e mira dhe te keqija, zgjidhjet dhe kostot e mbetjeve inerte, të renda dhe organike) etj.

c. Kontraktori duhet të mundësojë shpërndarjen e materialeve informative një herë në 3-muaj. Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotje, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë banoret për tu bërë pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që
kërkohet:**

<u>PREVENTIVI PËRMBLEDHËS (PËR 1 VIT)</u>						
OBJEKTI : PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUJË						
INVESTITOR : BASHKIA KRUJË						
VENDODHJA : QYTET FUSHË - KRUJË						
NR	KODI	EMËRTIMI I SHËRBIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	analize	Pastrim me autofshesë i rrugëve, shesheve	m2	27500		
2	analize	Pastrim me fshesë i rrugëve, shesheve e trotuareve	m2	19500		
3	analize	Transport mbetje urbane	ton	5480		
4	analize	Larje rrugësh, sheshesh e trotuaresh.	m2	45000		
5	analize	Pastrim territori urban	m2	17650		
6	analize	Sistemim e ngarkim me eskavator 0.25 m3 ne mjet dheu, zhavorriste, inerte barishte etj	m3	1070		
		Shuma				
		T.v.sh.		20%		
		SHUMA TOTALE				
Paraqiti preventivin permbledhes vjetor per subjektin _____						

<u>PREVENTIV MUJOR (7 MUAJ)</u>						
OBJEKTI : PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUJË						
INVESTITOR : BASHKIA KRUJË						
VENDODHJA : QYTET FUSHË - KRUJË						
NR	KODI	EMËRTIMI I SHËRBIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	analize	Pastrim me autofshesë i rrugëve, shesheve	m2	27500		
2	analize	Pastrim me fshesë i rrugëve, shesheve e trotuareve	m2	19500		
3	analize	Transport mbetje urbane	ton	456.67		
4	analize	Larje rrugësh, sheshesh e trotuaresh.	m2	45000		
5	analize	Pastrim territori urban	m2	17650		
6	analize	Sistemim e ngarkim me eskavator 0.25 m3 ne mjet dheu, zhavorriste, inerte barishte etj	m3	89.16		
		Shuma				
		T.v.sh.		20%		
		SHUMA TOTALE				
Paraqiti ofertën e shërbimit mujor për subjektin _____						

PREVENTIV MUJOR (5 MUAJ)

OBJEKTI : PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUJË

INVESTITOR : BASHKIA KRUJË

VENDODHJA : QYTET FUSHË - KRUJË

NR	KODI	EMËRTIMI I SHËRBIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	analize	Pastrim me autofshesë i rrugëve, shesheve	m2	27500		
2	analize	Pastrim me fshesë i rrugëve, shesheve e trotuaresh	m2	19500		
3	analize	Transport mbetje urbane	ton	456.67		
4	analize	Larje rrugësh, sheshesh e trotuaresh.	m2	0		
5	analize	Pastrim territori urban	m2	17650		
6	analize	Sistemim e ngarkim me eskavator 0.25 m3 ne mjet				
		dheu, zhavorrishte, inerte barishte etj	m3	89.16		
		Shuma				
		T.v.sh.		20%		
		SHUMA TOTALE				

Paraqiti ofertën e shërbimit mujor për subjektin _____

Afatet e ekzekutimit:

GRAFIKU VJETOR PËR PASTRIMIN E QYTETIT FUSHË - KRUJË

OBJEKTI : PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUJË

INVESTITOR : BASHKIA KRUJË

VENDODHJA : QYTET FUSHË - KRUJË

Nr	Emërtimi i shërbimeve	Njësia	Sasia	Shta	Teto	Nent	Dhje	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qers	Korr	Gush
				dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj	dit/muaj
1	Pastrim me autofshese i rrugëve, shesheve	m2	27500	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22
2	Pastrim me fshese i rrugëve,shesheve e trotuaresh	m2	20650	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22
3	Pastrim ,transport mbetje urbane	ton	5480	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26
4	Larje rruges,sheshesh e trotuaresh	m2	45000			21	21	21	21	21	21	21			
5	Pastrim territori urban.	m2	17650	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22
6	Sistemim e ngarkim me eskavator 0.25 m3 ne mjet														
	dheu , zhavorrishte , inerte , barishte transport etj	m3	1070	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8

Paraqiti grafikun e shërbimit vjetor për subjektin _____

GRAFIKU I SHËRBIMIT PËR PASTRIMIN E QYTETIT FUSHË - KRUJË GJATË 1 (NJË) MUAJI PËR 7 SHTATË MUAJ																																	
OBJEKTI : PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUJË INVESTITOR : BASHKIA KRUJË VENDODHJA : QYTET FUSHË - KRUJË																																	
Nr	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	SIPAS DITËVE TE MUAJIT																													
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
1	Pastrim me autofshese i rrugeve, shesheve	m2	27500	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	
2	Pastrim me fshese i rrugeve,shesheve e trotuaresh	m2	20650	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	
3	Pastrim , transport mbetje urbane	ton	456.7	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	
5	Larje rruges , sheshesh e trotuaresh	m2	45000	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po		Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	
6	Pastrim territori urban	m2	17650	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po	
7	Sistemim e ngarkim me eskavator 0.25 m3 ne mjet dheu , zhavorrishte , inerte , barishte transport etj	m3	89.16	Po		Po						Po		Po				Po		Po						Po		Po					
Paraqiti grafikun e shërbimit mujor për subjekti _____																																	

<u>GRAFIKU I SHËRBIMIT PËR PASTRIMIN E QYTETIT FUSHË - KRUJË GJATË 1 (NJË) MUAJI PËR 5 (PESË) MUAJ</u>																													
OBJEKTI : PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUJË																													
INVESTITOR : BASHKIA KRUJË																													
VENDODHJA : QYTET FUSHË - KRUJË																													

Nr	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	SIPAS DITËVE TE MUAJIT																														
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
1	Pastrim me autofshese i rrugeve, shesheve	m2	27500	Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	
2	Pastrim me fshese i rrugeve, shesheve e trotuaresh	m2	20650	Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	
3	Pastrim , transport mbetje urbane	ton	456.7	Po	Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po
5	Larje rruges , sheshesh e trotuaresh	m2	0															Po	Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po
6	Pastrim territori urban	m2	17650	Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	Po	Po	Po			Po	Po	
7	Sistemim e ngarkim me eskavator 0.25 m3 ne mjete dheu , zhavorrishte , inerte , barishte transport etj	m3	89.16		Po		Po				Po		Po					Po		Po						Po		Po						

Paraqiti grafikun e shërbimit mujor për subjektin _____

GRAFIKU I SHËRBIMIT PËR PASTRIMIN E QYTETIT FUSHË - KRUJË GJATË 24 ORËVE																											
OBJEKTI : PASTRIM I QYTETIT FUSHË - KRUJË																											
INVESTITOR : BASHKIA KRUJË																											
VENDODHJA : QYTET FUSHË - KRUJË																											
Nr	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
1	Pastrim me autofshese i rrugeve, shesheve	m ²	27500																								
2	Pastrim me fshese i rrugeve,shesheve e trotuaresh	m ²	20650																								
3	Pastrim , transport mbejte urbane	ton	17.56																								
5	Larje rrugesh , sheshesh e trotuaresh	m ²	45000																								
6	Pastrim territori urban	m ²	17650																								
7	Sistemim e ngarkim me eskavator 0.25 m3 ne mjete dheu , zhavorrishte , inerte , barishte transport etj	m ³	11.15																								
Paraqiti grafikun për subjektin																											

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (ne vleren prej 2 % fondit limit te kontrates qe prokurohet)*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2025 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2025 per secilin operator)

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.10, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me

nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2025 te lëshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operateveve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2022 per secilin operator).*

2.2Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

b)-Ofertuesi duhet te jete pajisur dhe te paraqese licencë të vlefshme te shoqerisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL)/Autoriteti kompetent sipas ligjit , Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis “, Nënkatgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

3.2-a) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2022,2023,2024), të certifikuara nga autoritetet përkatëse kompetente tatimore (Drejtoria Rajonale te Tatimeve) , që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse ne treguesit e bilanceve per dy vite te njepasnjeshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

3.2.b-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2022,2023,2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vleras e fondit limit te kontrates qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej, **19’725’580 (nëntembdhjete milion e shtateqind e njezet e pese mije e pesëqind e tetëdhjete) lekë pa tvsh.**

Shenim-Pika3.2-b) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

3.3 - Kapaciteti teknik:

a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për shërbime te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates **me një vlerë jo me te vogel se 40 % e vlerës** së përlllogaritur të kontratës/lotit që prokurohet .

Për të vërtetuar këtë Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

3.4-.Personeli dhe fuqia punëtore:

Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për ekzekutimin e kontratës dhe për të provuar këtë kusht duhet të ketë **një punësim mesatar për tre muajt e fundit të deklaramit sipas legjislacionit fiskal në fuqi , duke nisur nga data e dorëzimit të ofertave, i të pakten 17 (shtatëmbdhjetë) personave duke përfshirë stafin e përhershëm të provuar me :**

- Vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Qarkut ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të qarkut përkatës ose vërtetim lëshuar nga platforma elektronike E-Albania .

ose

- Listë pagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 025) sipas formatit elektronik në përputhje me VKM nr 922 datë 29.12.2014''**Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike''**

Shënim- Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, **sipas shtojcës nr.10** , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

3.5)Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1(një) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerve të rënda (specifikisht 1(një) manovrator për Eskavator/Fadrome me Goma).

Për çdo profil punonjësi teknik si më sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (përgjate gjithë periudhës së realizimit/ekzekutimit të shërbimit të kontratës), dëshmitë e aftësive profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019.

Shënim- Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, **sipas shtojcës nr.10** , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

3.6-).Operatorët ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, 1(një)Drejtues Teknik të shërbimit të pastrimit për objektin e

kontratës, te cilen duhet te paraqesi kontratë pune te vlefshme(me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit te shërbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, **sipas shtojcës nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

3.7-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

Lloji i makinerisë & mjeteve (pajisjes)	Njesia	Sasia
Autofshesë me kapacitet 3 - 4 m ³ ,me fshesa rrul e flutur.	copë	1
Kamion vetëshkarkues me peshë mbajtëse 5 ton	copë	1
Fadrome me goma me kapacitet te koves 0.25- 1 m ³	copë	1
Autobot uji për larje rrugësh.	copë	1
Kontenierë mbeturinash 1100 litra (1.1 m ³)	copë	22
Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet 6 - 8 m ³	copë	1
Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet 8 - 10 m ³	copë	1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).*
- Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje.*

(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, **sipas shtojcës nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

3.8-)Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Shenim: Ne zbatim te nenit 82.5 te Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe te pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike⁷. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit te operatorit fitues para lidhjes se kontrates , ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimin. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

⁷ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
